

VENDIM
Nr. 114, datë 26.4.2021

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME, NGA
GJENERATORËT E VEGJËL ME BURIM TË RINOVUESHËM, NGA PJESA E
BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË
MBETURINA INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 26.4.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”,

konstatoi se:

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 mw dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 mw për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020”.

- Përpara kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1249 prot., datë 7.12.2020, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) informacion në lidhje me autorizimet paraprake apo miratimet përfundimtare që janë dhënë nga kjo e fundit, gjatë vitit 2020, në lidhje me ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, si dhe për gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale.

- MIE, me anë të shkresës nr. 1249/1 prot., datë 29.12.2020, është shprehur se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, nuk ka lëshuar asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm, nga pjesa e

biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti